REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY
SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR
Njësia Org. Org.Jedinica Org Unit 01B
Nr.Prot: Broj Prot: Prot.No: 1976
Nr.i faqeve Br.stranica No.pages 2
Data: Datum: Date: 16,06,2015
Prishtinë / a

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

***Qeveria – Vlada - Government***

***Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology***

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

---

Datë: 15 qershor 2015
Ref. 234/01B

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të nenit 8 (1.4) dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dt. 22.03.2011, nenit 5 (5) të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimi Parauniversitar në Republikën e Kosovës, në bazë të Udhëzimit Administrativ 10/2008 për emërtimin dhe riemërtimin e shkollave dhe në bazë të kërkesës së DKA-së në Gjilan nr. 1669 të datë: 18.05.2015, nxjerr:

## V E N D I M

1. Shkolla Fillore e Mesme e Ulët "Lagjja e VIII" në Gjilan emërtohet si Shkolla Fillore e Mesme e Ulët "Nazmi Hoxha".

2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e lartshënuara dhe kërkesën e DKA-së në Gjilan nr. 1669, dt. 18.05.2015, kërkesën e Këshillit të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët në Gjilan nr. 62/14, dt. 18.11.2014, Komisioni për Emërtimin dhe Riemërtimin e Shkollave në MAShT, në mbledhjen e mbajtur më 03.06.2015, shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar në MAShT dhe konstatoi se lënda ka kaluar nëpër procedurë të rregullt. Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, ka përkrahur propozimet dhe ka rekomanduar propozimin e bërë nga Këshilli i Shkollës të cilin e ka arsyetuar me shkrim në kërkesën e dorëzuar në MAShT, prandaj Komisioni i MAShT miratoi propozimin që Shkolla Fillore e Mesme e Ulët të emërtohet "Nazmi Hoxha". Duke u mbështetur në këto argumente, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilla juridike:**
Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të ushtroj ankesë në afat prej 30 ditësh në Komisionin për ankesa dhe parashtresa në MAShT.

Arsim BAJRAMI

__________________________________________

Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

**Vendimi ju dorëzohet:**
1. Drejtorisë Komunale të Arsimit në Gjilan;
2. Shkollës Fillore e Mesme e Ulët në Gjilan;
3. Komisionit për Emërtimin dhe Riemërtimin e Shkollave në MAShT;
4. Arkivit në MAShT.